



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010) dhe neneve 7, 13 dhe 20 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 30 prill 2015 miratoi si në vijim:

Rregullore mbi Llogaritë Individuale të Pjesëmarrësve

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për mirëmbajtjen e llogarive individuale të pjesëmarrësve me kontribute të definuara dhe llogarive të kontributeve me benefit të definuar, të cilat sigurojnë transparencën në lidhje me mirëmbajtjen e kontributeve pensionale, administrimin dhe menaxhimin e mjeteve pensionale, praktikat më të mira të investimeve të fondeve pensionale.
2. Kjo Rregullore aplikohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), Fondin Plotësues Pensional të Punëdhënësit (“Fondi i Pensionit”) dhe Ofruesit të Pensioneve Plotësuese Individuale (“Ofruesi i Pensioneve”).

Neni 2 Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 (Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës) ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. **“Deklarata e parimeve të investimit”**, nënkupton politikën investuese dhe objektivat e zhvillimit të investimeve të përshtatura nga entiteti i pensionit për investimin e mjeteve të pensioneve, e cila duhet të jetë në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e BQK-së për pensione, ose me direktivat e investimit të cilat entiteti i pensionit ia përcakton menaxherëve të mjeteve ose mbajtësit.
 - 1.2. **“Direktivat Investuese”**, nënkupton urdhrat dhe udhëzimet e bëra nga entiteti i pensionit për menaxherin (et) e mjeteve ose mbajtësit që specifikojnë termet, kushtet dhe mënyrën e investimit të mjeteve të pensioneve në pajtim me deklaratën e parimeve të investimit.

- 1.3. **“Performanca e investimeve”**, nënkupton fitimin/humbjen e realizuar, në investimet e mjeteve të pensioneve.
- 1.4. **“Viti financiar”** nënkupton periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të atij viti.
- 1.5. **“Rreziku i investimit”**, nënkupton ekspozimin e mjeteve pensionale ndaj pasigurive gjatë periudhës së investimit, sidomos kur shkalla e të ardhurave nuk është fikse dhe e garantuar.
- 1.6. **“Entiteti i Pensionit”**, nënkupton FKPK-në, Fondin e Pensionit dhe Ofruesit e Pensioneve.
- 1.7. **Benefit i Definuar**, nënkupton pension i shumave të caktuara - një pension i cili llogaritet në bazë të një formule për të cilën punëdhënësi ose një pjesëmarrës individual ka marrë përsipër obligimin për të kontribuar në baza vjetore një shumë të caktuar në përputhje me aktet normative të fondit pensional ose me rregullat pensionale dhe vlerësimin aktuarial. Formula për një pension të caktuar mund të përcaktohet në bazë të shumës së rrogës mesatare të pjesëmarrësit dhe kohëzgjatjes së shërbimit të punëdhënësi, siç mund të përkufizohet më tej nga BQK-ja, ose të përcaktohet ndryshe me rregulloret mbi pensionet.
- 1.8. **Kontribut i Definuar**, nënkupton pension i kontributeve të caktuara - pension në të cilin kontributet e bëra në emër të pjesëmarrësve përlllogariten si përqindje e rrogave të tyre ose në ndonjë bazë tjetër të rregullt dhe depozitohen në llogaritë individuale, ku pensionet llogariten vetëm në bazë të shumave të kontribuara dhe çfarëdo të ardhurash, shpenzimesh, fitimesh dhe humbjesh (nëse ekzistojnë) të ndara në llogari individuale. Punëdhënësi mund të zgjedhë shkallën e kontributit të tij, nëse ekzistojnë shkallë të tilla, në emër të pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësit mund të zgjedhin secili shkallën e kontributit të tyre, nëse ekzistojnë shkallë të tilla. Punëdhënësi mund të kontribuojë pjesërisht ose plotësisht në bazë të shumës të cilën e ka paguar pjesëmarrësi. Pjesëmarrësi mund kontribuojë vetëm në emër të tij.

Neni 3

Obligimet e Entitetit të pensionit ndaj pjesëmarrësve dhe përfituesve të pensioneve

1. Përveç obligimeve tjera të përcaktuara në Ligjin për Fonde Pensionale dhe rregulloret e BQK-së, entitetet e pensionit i detyrohen pjesëmarrësve dhe përfituesve të pensioneve me obligimet si vijojnë:
 - 1.1. Mbajtja e shënimeve, kontabilitet të kontributeve dhe të ardhurat nga investimet, duhet të mbahen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabiliteti (SNK), dhe në përputhje me rregullat dhe standardet shtesë të përcaktuara nga BQK-ja.
 - 1.2. Entitet i pensionit që ofron pensione me kontribut të definuar duhet t’ju sigurojë pjesëmarrësve pasqyrën vjetore të llogarisë individuale.

- 1.3. Entiteti i pensionit duhet të sigurojë informatat pjesëmarrësve në lidhje me rregullimin pensional dhe investimet e mjeteve pensionale të kërkuara nga pjesëmarrësit në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 4

Pasqyra e Llogarisë Individuale

1. Forma dhe Përmbajtja:
 - 1.1. Forma dhe përmbajtja e pasqyrës së llogarisë individuale e përpiluar nga Entiteti i Pensioneve, paraprakisht duhet të aprovohet nga BQK-ja.
 - 1.2. Pasqyra e llogarisë individuale duhet të përmbajnë minimumin e informatave si vijon:
 - 1.2.1. Emri, mbiemri, numri personal identifikues dhe adresa e pjesëmarrësit,
 - 1.2.2. Emri i punëdhënësit ose punëdhënësve kontribuues,
 - 1.2.3. Periudha e raportimit-data (prej – gjer më) për pranimin e kontributeve të pasqyruara në formular dhe data e vlerësimit nëse është ndryshe prej datës “gjer më”.
 - 1.2.4. Shuma e kontributeve që në mënyrë të saktë tregon kontributet e pjesëmarrësve dhe kontributet e dhëna nga punëdhënësi ose punëdhënësit në emër të pjesëmarrësit.
 - 1.2.5. Shuma e të ardhurave ose humbjeve të shpërndara nga investimet që është shtuar ose zbritur prej llogarisë individuale .
 - 1.2.6. Bilanci i akumuluar i llogarisë individuale te pjesëmarrësit si e datës “gjer më” .
 - 1.3. BQK-ja mundet në çdo kohë të kërkojë informata të tjera të nevojshme që të përfshihen në pasqyrat e llogarive individuale të shfrytëzuara nga Fondi i Pensionit dhe Ofruesit e Pensionit.
2. Koha brenda së cilës duhet të sigurohen pasqyrat e llogarive individuale
 - 2.1. Entiteti i Pensioneve duhet të sigurojë pasqyra të llogarisë individuale për pjesëmarrësit e pensioneve së paku një herë në vit falas, brenda 3 muajsh pas përfundimit të vitit financiar.
 - 2.2. Pjesëmarrësi i pensioneve vullnetare mund ta ndërpresë në çdo kohë pjesëmarrjen në fondet e pensioneve vullnetare. Mirëpo Ofruesi i Pensioneve vullnetare duhet të sigurojë pasqyrën e llogarisë individuale për pjesëmarrësit e tyre së paku një herë në vit për periudhën e pjesëmarrjes.
 - 2.3. Entiteti i Pensioneve përmes faqes zyrtare duhet të sigurojë pjesëmarrësve në çdo kohë qasje direkt në pasqyrat e llogarive individuale.

- 2.4. Pasqyra e llogarisë individuale me kërkesë të pjesëmarrësit duhet të sigurohet brenda 15 ditësh nga data kur është parashtruar kërkesa. Entiteti i Pensioneve për sigurimin e pasqyrës së kërkuar, mund të ngarkojë pjesëmarrësin me një tarifë të arsyeshme.

Neni 5

Informatat relevante të pensionit

1. Detyra për të siguruar informatat për pensionin:
 - 1.1. Fondi i Pensionit duhet të sigurojë informacionin komplet për pjesëmarrësit para regjistrimit të tyre në fondin pensional, lidhur me rregullimin pensional, menaxhimin dhe administrimin e pensionit, investimin e mjeteve të pensioneve dhe rrezikun e investimit që bart pjesëmarrësi. Një kopje e planit pensional duhet t'u jepet të gjithë pjesëmarrësve menjëherë pas pjesëmarrjes në Fondin Pensional.
 - 1.2. Para lidhjes së kontratës së pensionit, Ofrues i Pensionit duhet të sigurojë informacionin komplet për pjesëmarrësit, lidhur me rregullimin pensional, rrezikun e investimit që bart pjesëmarrësi, kushtet, afatet, tarifa e menaxhimit, tarifat hyrëse dhe tarifat dalëse dhe tarifat e tjera që i kërkohet pjesëmarrësit t'i paguajë. Një kopje e Planit Pensional duhet t'u jepet të gjithë pjesëmarrësve menjëherë pas pjesëmarrjes në Fondin Pensional.
 - 1.3. Entiteti i Pensioneve duhet të përgatitë një raport vjetor në fund të çdo viti financiar dhe të publikojë në faqen zyrtare të tij jo më vonë se 5 muaj nga përfundimi i vitit financiar.
 - 1.4. Raporti vjetor duhet të përmbajë informatat si vijon:
 - 1.4.1. Një pasqyrë të raportit vjetor të skemës së pensionit, statistikën e anëtarësisë dhe zhvillimet gjatë vitit.
 - 1.4.2. Shqyrtimin e politikës investuese, objektivat dhe zhvillimet aktuale të investimit.
 - 1.4.3. Pasqyrat Financiare të Audituar.
 - 1.4.4. Raportin e ekspertit të pavarur në rastin e rregullimit pensional me benefit të definuar.
 - 1.5. Entitetet e Pensionit duhet të publikojnë në faqen zyrtare të tyre si vijon:
 - 1.5.1. Informatat lidhur me Ligjin për Fondet Pensionale në Kosovë, rregulloret e BQK-së për pensione, rregullat e pensionit, legjislacionin tatimor, social dhe të punës si dhe legjislacion tjetër që mund të ndikojë në të drejtat dhe obligimet e tyre brenda 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtyre akteve.
 - 1.5.2. Ndryshimet në deklaratën e parimeve dhe direktivën e investimeve, brenda 30 ditësh prej datës kur ndryshimi bëhet efektiv.

- 1.5.3. Përveç detyrimit të publikimit në faqen zyrtare për ndryshimet sipas nën paragrafëve 1.5.1 dhe 1.5.2 të këtij paragrafi entitet e pensioneve, paraprakisht duhet të njoftojnë BQK-në.
- 1.5.4. Informatat duhet të jenë të publikuara në gjuhët zyrtare të aplikueshme në Kosovë.
- 1.6. Entiteti i Pensionit me kërkesën e pjesëmarrësit duhet të sigurojë, kundrejt një tarifë të arsyeshme, brenda 15 ditësh informatat si vijojnë:
- 1.6.1. Një kopje të Raportit(ve) Financiar Vjetor të Audituar.
- 1.6.2. Informatat mbi shkallën e mundësive investuese, performancën aktuale të portofolios dhe kthimit nga investimet.
- 1.6.3. Ekspozimi ndaj rrezikut, masat e aplikuara ndaj rrezikut të investimit dhe proceset e menaxhimit të rrezikut, tarifat dhe shpenzimet lidhur me investimet e mjeteve pensionale.
- 1.6.4. Benefiti i vlerësuar i pensionimit dhe opsionet e ndryshme të pagesave të pensionit për pjesëmarrësit që priten të pensionohen brenda 2 viteve.
- 1.6.5. Informatat e tjera relevante mbi pensionet që jenë në dispozicion prej shënimeve të mbajtura nga Entiteti i Pensionit.

Neni 6

Zbatimi dhe Masat Përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregullore do të jenë subjekt i masave të parashikuara me nenin 32 dhe 33 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.

Neni 7

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore do të shfuqizohet Rregulla 7 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Sigurimin dhe mirëmbajtjen e llogarisë individuale të pjesëmarrësit dhe informata të tjera relevante të pensionit të datës 25 korrik 2005.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 maj 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Bedri Peci